



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



PROGRAM

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: GJEOGRAFIA E EKONOMISË SË TURIZMIT

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Dhimitër DOKA & Prof.as.dr. Jostina DHIMITRI
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (2 leksione dhe 2 seminare në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Programi i studimit:</i>	Master Shkencor, gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

Shkurtesë: Lënda ka si qëllim analizën e *efekteve ekonomike dhe joekonomike*, si dhe përbërësit përkatës të efekteve jo ekonomike të drejtëpërdrejta dhe efekteve jo ekonomike jo të drejtëpërdrejta që ndodhin nga zhvillimi i aktivitetit turistik. Më tej kalohet në turizmin si dukuri ekonomike, klasifikimi i efekteve ekonomike të turizmit dhe në detajimin e tyre, përkatesisht: efektet ekonomike të turizmit të drejtëpërdrejta dhe efektet ekonomike të turizmit jo të drejtëpërdrejta.

Temat e leksioneve:

Karakteristikat bazë të zhvillimit të turizmit si dukuri ekonomike. Analizohen temat baze dhe ato fillestare për të kuptuar koptimin dhe ekzistencën e dukurisë turizem. Me tej, analizohen kuptimi i termave turist dhe turizëm, karakteristikat e dukurisë turizëm, disiplinat shkencore që studiojnë turizmin, metodat e studimit të turizmit, etj.

Faktorët që mundësojnë zhvillimin e turizmit si sistem, social dhe mjedisor. Analize e detajuar e faktorëve nxitës të kërkesës, faktorëve të ofertës, faktorëve ndërmjetësues dhe se fundmi, konkretisht, rasti faktorëve të zhvillimit të turizmit në Shqipëri apo destinacioneve të ngjashme me Shqipërinë.

Koncepti turizëm si sistem ekonomik. Jepet një analizë e detajuar e sistemit turistik me të gjithë perberësit e vet. Analizohen teorikisht dhe shpeshherë edhe me raste konkrete sipas rrjedhës logjike paradigmat njohëse të turizmit, paradigmat sistematike të turizmit, dhe se fundmi analizohet turizmi si rezultante e shërbimeve dhe veprimtarive produktive.

Modelet e zhvillimit të turizmit. Analizohen disa prej modeleve kryesore që përdoren në ditët e sotme për destinacionet turistike, qoftë për qëllime të planifikimit, marketingut apo zhvillimit të qendrueshëm.

Tipet e turizmit aktiv dhe pasiv. Tipet e turizmit të drejtëpërdrejtë dhe tipet e turizmit jo të drejtëpërdrejtë. Disa forma të joturizmit. Analiza e destinacioneve turistike pasive. Organizimi i vendeve të turizmit pasiv dhe tipet e vendeve të turizmit pasiv janë pjesë e rëndësishme në këtë program si dhe në cdo tip vlerësimi turistik i cdo destinacioni turistik.

Dokumentimi statistikor i lëvizjes turistike. Ketu analizohen të detajuara këto grupime: Dokumentimi i fluksit turistik të emtuar; Dokumentimi numerik i qarkullimit turistik; Dokumentimi numerik i strukturave pritëse, parapritëse, plotësuese; Treguesit kohorë; Disa indekse çmimesh; Tregues relativ të lëvizjes turistike; Treguesit e rezistencës specifike; Treguesit e strukturës së lëvizjes; Tregues të përdorimit të strukturave pritëse; Tregues të efektivitetit ekonomik. Këto grupime janë pjesë përbërëse të

cdo analize, projekti apo procesi monitorimi te planeve dhe strategjive te zhvillimit turistik.

Tendencat e turizmit në të ardhmen. Per shkak te ndryshimeve te shpeshta jo vetem ne sjelljet e turisteve ne nivele nderkombetare por edhe te tendencave te ndryshimit te shpesht te formave dhe tipeve te turizmit te perdorura apo frekuentuara, analize ne kete pjese eshte ndalur ne: Turizmi në mileniumin e tretë, Turizmi dhe shoqëria në mileniumin e tretë, E ardhmja e turizmit në Evropë duke u konsideruar Evropa si destinacion i vetem turistik dhe mjaft konkurrues ne nivele boterore, Tendencat në turizmin Evropian, si dhe ndikimet në marketingun e turizmit në Evropë. Me tej dhe se fundmi analiza ndalet ne te ardhmen e turizmit në Shqipëri.

Teknologjia, Informacioni dhe Komunikimi ne Industrine e Turizmit, Udhetimeve dhe Mikpritjes. Analiza ndalet ne rolin e TIK-ut ne ditet e sotme, ne marredhenien midis Teknologjise Informative dhe Industrise se Udhetimeve, turizmit dhe mikpritjes. Me pas analizohen te gjitha karakteristikat e sistemeve kompjuterike te perdorura ne turizem si psh Sistemet globale te shperndarjes si dhe jepen disa karakteristika te internetit.

Turizmi i qëndrueshëm dhe zhvillimi ekonomik i një destinacioni. Ne fillim jepen konceptet baze te qendrueshmërise, zhvillimit te qendrueshëm dhe turizmi i qendrueshëm, me tej ndalemi ne turizmin e qendrueshëm dhe krijimi i rregullave në nivele globale dhe rajonale., si dhe ne tri dimensionet dhe aktoret kryesore te turizmit te qendrueshem.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

1. GORICA K.. – BAZAT E TURIZMIT (SHBLU), TIRANE 2009
2. MARKETINGU I TURIZMIT GORICA-KOJA, 2008
3. MARKETINGU I TREGUT TURISTIK SHQIPTAR – DOMOSDOSHMERI EKONOMIKE, GORICA. K, 2002
J.SËARBROOKE: SUSTAINABLE TOURISM MANAGEMENT, 2005

MIRATOI
Përgjegjësi i Departamentit
Prof. dr. Romeo HANXHARI

Tiranë, 2016